

Kompania Rajonale e Ujësjellësit
Regional Water Supply Company

RADONIQI

sh.a. - j.s.c.

Rruga "UÇK" 7 Gjakovë

Tel:+381 390 320 503

Fax:+381 390 320 997



PROTOKOLI

Gjakovë Rahovec Lumbardh	22.04.2010	Nr.: 1020
--------------------------------	------------	-----------

Projekti

Gj-1

hidroing. i dipl. Jeton Shasivari, udhëh. për digë dhe liqe
hidroing. i dipl. Shpejtim Hadri, udhëh. për zhvillim dhe planifikim

AKTIVITETET PËR NGRITJEN E EFIKASITETIT MENAXHUES

Projekti:
Ndërrimi i gypave primar të ujësjellësit
në qytetin e Gjakovës
Sponsor:
Qeveria e Republikës së Kosovës,
granti për 2010

PLANI ZHVILLIMOR I KRU "RADONIQI"

Kushtet e përgjithshme dhe teknike për kryerjen e punimeve ndërtimore, mjeshtrore dhe montuese

Kushtet e përgjithshme

1. Të gjitha punimet e parashikuara me këtë elaborat, paramasa me paralogari, nënkuptojnë sigurimin e materialit në tërësi (materialin kryesor dhe ndihmës), duke i shtuar mjetet e punës dhe mekanizmat. Në përgjithësi tërë ajo që duhet për kryerjen e punimeve sipas pozicioneve në paramasë dhe paralogari, duke iu përmbajtur gjithnjë planeve të ofruara, detaleve, përshkrimit teknik, rregullave teknike në fuqi për lëndën e llojit të punës, standardeve dhe udhëzimeve të dhëna nga organi mbikëqyrës.
2. E tërë puna duhet të kryhet saktësisht dhe në mënyrë profesionale. Para se të përdoret dhe vehet në punë, secili material duhet të shikohet dhe pranohet nga organi mbikëqyrës.
3. Punët konsiderohen të kryera tërësisht, atëherë kur produkti final është i gatshëm për përdorim, gjë që konsiderohet se çmimet e kalkuluara janë përmbushur sipas kontratës.
4. Çmimet e kryesit të punimeve do të jenë të qëndrueshme dhe ato do të përfshijnë të gjitha aktivitetet deri në finalizim të të gjitha pozicioneve, përfshirë këtu edhe vlerën e materialit kryesor dhe ndihmës, duke llogaritur edhe fuqinë punëtore, punën e mekanizmave, transportin e brendshëm dhe të jashtëm, përdorimi i mjeteve të punës, skeleve dhe kallëpeve, e tj. si dhe harxhimet tjera që kanë të bëjnë me kryerjen e këtyre punimeve: regjia, fitimi, kontributet shoqërore, taksat dhe të gjitha ato që janë të kushtëzuara me rregulloret në fuqi.
5. Para prurjes së ofertës, marrëveshjes (kontraktimit) dhe fillimit të punimeve, kryesi i punimeve është i obliguar të shikoj terrenin dhe të incizoj gjendjen ekzistuese, duke krijuar pasqyrën e të gjitha kushteve të veçanta dhe rrethanat eventuale nën të cilat duhet të kryhen punimet sipas këtij projekti, ashtu që çmimet e ofruara dhe të kontraktuara të nënkuptohen si çmime njësi dhe me vërtetimin e sasive nga organi mbikëqyrës, ato bëhen përfundimisht të pranueshme.
6. Për të gjitha dëmet të cilat mund të ndodhin gjatë punimeve (dëmet për objektin në fjalë apo objektet fqinje), obligohet kryesi i punimeve dhe është përgjegjës për dëmshpërblim me harxhimet e veta.
7. Investitori, për shkak të natyrës së punimeve dhe lokacionit me komunikacion të ngjeshur, nuk detyrohet t'i siguroj kryesit të punimeve hapësirën e mjaftueshme, në përdorim, për organizimin e punishtes, pra për këtë obligohet kryesi i punimeve.
8. Furnizimi me ujë, energji elektrike dhe lëndë të nevojshme, për tërë kohëzgjatjen e punimeve i takojnë kryesit të punimeve, duke i bashkëngjitur të gjitha harxhimet administrative në lidhje me këtë.

9. Para fillimit, si dhe gjatë ekzekutimit të secilit pozicion, kryesi i punimeve është i detyruar të kërkoj ndihmë dhe shpjegime nga organi mbikëqyrës ose projektuesi, përndryshe ka përgjegjësi materiale nëse ndonjë pozicion apo detal nuk është kryer sipas projektit kryesorë.

10. Nëse paraqitet nevoja për kryerjen e ndonjë pune të paparaparë me projekt, kryesi i punimeve është i detyruar të pranoj me shkrim pëlqimin nga organi mbikëqyrës si për vet fillimin ashtu edhe konceptin se si duhet të kryhet, çmimin, afatin e tj. e tek pastaj të filloj me punën. Nëse kjo nuk kërkohet me shkrim dhe punët janë krye, do të konsiderohet si pozicion që më parë është kalkuluar në çmimin fillestar dhe nuk do të paguhet posaçërisht.

11. Para fillimit të punimeve, kryesi i punimeve do t'i jep investitorit me shkrim: emrin e mbiemrin dhe adresën e personit përgjegjës (shefit të punishtes). Gjatë rrjedhës së punimeve ky person nuk bën të ndërrohet pa pëlqimin e investitorit.

12. Duke pas parasysh se kryesi i punimeve është detalisht i njoftuar me projektin kryesor ndërtimor, dhe me të gjitha kushtet lokale dhe rrethanat në të cilat puna duhet të kryhet, afati kohor i punimeve nuk bënë të zgjatet (përveç nëse pranohet arsyeja nga investitori dhe organi mbikëqyrës). Në të njëjtat kushte të nënshkrimit të marrëveshjes për kryerjen e punimeve, është jashtë çdo mundësie „e drejta“ e tij për ndërrimin e çmimit ekzistues për shkak të ngritjes së çmimit të materialit, sepse në lidhje me vëllimin e punëve relativisht më të vogla dhe llojit të materialit nënkuptohet se e tërë kjo është siguruar menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes.

13. Mënyra e pagesës do të jetë e rregulluar me marrëveshje.

14. Nëse ndonjë punë nuk është kryer sipas dokumentacionit teknik, ajo nuk do të pranohet, as të paguhet. d.m.th. hiqet mundësia e pagesës, për shkak të punës jo kualitative ose për materialin e përdorur. Kjo duhet të arrihet me shpenzimet e kryesit të punimeve.

15. Kryesi i punimeve është i detyruar që gjatë punimeve të mbaj ditarin e punës dhe librin ndërtimor dhe të njëjtat t'ia ofroj për kontroll organit mbikëqyrës, i cili do ti vëtetoj.

16. Me të përfunduar punimet, kryesi i punimeve është i detyruar t'i largoj nga punishtja dhe hapësira e shfrytëzuar të gjitha veglat dhe mekanizmin, materialin tepriçë e tj. ashtu që punishtja të jetë në koncept të kompletimit të dokumentacionit investiv - teknik në gjendjen e para fillimit të punimeve.

17. Në obligimet e kryesit të punimeve bëjnë pjesë edhe ruajtja e punishtes dhe mirëmbajtja e objekteve ekzistuese për tërë kohën që punohet, deri në dorëzimin e objektit.

18. Këto kushte të përgjithshme, kushtet teknike, paramasa me parallogari, përshkrimi teknik, llogarit hidraulike dhe statike, si dhe të gjitha vizatimet janë pjesë përbërëse e marrëveshjes dhe vlejné të gjitha pjesët e sajë, përveç, nëse me marrëveshje arrihet ndonjë ndryshim.

Përshkrimi teknik me vërejtjet paraprake

Projekti: Ndërrimi i gypave primar në qytetin e Gjakovës, njëherit është pjesë e planit zhvillimor të KRU “Radoniqi”- Gjakovë

Lokacioni:

Lokacioni i projektit për ndërrimin e gypave primar është në mbrendi të qytetit të Gjakovës, mu në qendër të sajë, dhe fillon nga puseta që gjendet afër objektit të PTK-së dhe vazhdon në drejtimin jugorë nëpër rrugën Nënë Tereza (gjithnjë në krahun e djathtë të këtij drejtimi), dhe nëpër rrugën Skenderbeu deri te kryqëzimi me rrugën Yll Morina, te puseta afër mishtores Cana. E tëra është paraqitur në ortofoto, ku është shënuar pika e fillimit dhe e mbarimit.

Gjendja ekzistuese

Në potezin e lartëcekur, ekzistojnë gypat nga materiali i azbest-cimentos me diametër Ø300 nga puseta afër PTK-së e deri te nyja ndarëse pas Hotel Pashtrikut (para urës së Islam Begut), ku ekziston puseta me njësin për matjen e sasisë Ø250 (dataloger) me lexim nga qendra. Prej aty e deri te kryqëzimi i rrugës Skenderbeu me rrugën Xheladin Hana dhe Washingtoni gypi është AC Ø250. Nga ky kryqëzim vazhdon gypi AC Ø150, deri te pika e fundit e këtij projekti, pra te kryqëzimi me rrugën Yll Morina.

Përgjat kësaj traseje, ekzistojnë 5 puseta, prej të cilave 3 kanë nevojë të zgjerohen ose zgjaten. Poashtu në këtë trase ekzistojnë 6 valvula në linjën primare, 8 valvula të degëzimeve, numër më i madhë (i panjohur) i valvulave në gypa furnizues për të dy krahët e rrugës, qafore të shumta në numër dhe mjaft të shpeshta. Këto valvula dhe qafore, tashmë me siguri që rrjedhin, dhe shkaktojnë humbje. Në tërësi, ky segment i rrjetit të ujësjellsit daton nga fundi i dekadës së gjashtë të shekullit të kaluar, që do të thotë më shumë se 40 vite. Prej atyre viteve e deri më sot, kjo pjesë e qytetit është rritur dhe akoma vazhdon të rritet me intenzitet të shtuar. Janë ndërtuar dhe janë në ndërtim e sipër, objekte shumëkatshe, me shumë njësi afariste dhe banuese. Gjithashtu, me planin rregullativ të kësaj pjese janë të parapara edhe shumë sosh. Prandaj, duke ditur se gypi nga pika fillestare e këtij projekti, puseta e PTK-së, e deri te nyja ndarëse para urës së Islam Begut (AC Ø300), përveç furnizimit të segmentit që i përket projektit, ajo furnizon edhe tërë qytetin e vjetër (në anën e djathtë të Lumit Krena) me një shtrirje nga pjesët më të largëta veriore e deri në fshatrat Brekoc, Meje, Firzë e tj. Gjithashtu kjo pjesë karakterizohet me pikat ekstreme më të larta (rrëzë Qabratit), dhe më të ulta (Brekoc dhe Meje). Prandaj ky gyp është menduar të ndërrohet edhe për rritjen e kapacitetit furnizues.

Gjithashtu, nga vibrimet e shkaktuara nga komunikacioni i makinerive të rënda transportuese mbi trasë gjatë ndërtimeve, dhe gropimet e gjëra për bodrume. kanë bërë që struktura e trasës së këtij gypi të lëviz, dhe këtë gypat AC e kanë dobësi, gjë e cila kohëve të fundit kemi pasur disa defekte të njëpasnjëshme. Riparimet na kushtojnë shumë, pasi që gypi kalon në ose shumë afër asfaltit rrugor. Prandaj ndërrimi i këtij gypi zvoglon shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes.

Në këtë trasë ekzistojnë 5 hidrantë nëtokësor, të cilët disa janë mbuluar me trotuare dhe nuk dihet se ku janë saktësisht, e për disa thuhet se nuk janë në funksion. Prandaj në këtë potez prej 1290m kemi parashikuar të instalojmë 7 hidrantë të tillë, sipas normativave në çdo 200m.

Gjatë intervenimeve për sanimin e defekteve në këtë gyp, që në 15 muajt e fundit kemi pasur 4 sosh. Kemi vërejtur se profili i mbrendshëm është i stërm bushur me materje korroduese, i cili përveç që ka zvogluar kapacitetin furnizues ai gjithashtu paraqet burimin e prishjes së cilësisë së ujit të pijshëm. Prandaj ndërrimi i këtij gypi ndikon edhe në përmirsimin e cilësisë së ujit.

Puseta e parë (afër objektit të PTK-së), ka vetëm 1 valvulë Ø500, dhe nga nevoja për ndërrimin e sajë dhe instalimin e 2 tjerave (Ø350 dhe Ø300), kemi paraparë zgjerimin e pusetës edhe për 1.2m në drejtim të rrugës. Të trija këto valvula janë tip flutur, për shkak të trupit më të shkurtër dhe përdorimit më të lehtë.

Puseta e dytë nuk ka nevoj të zgjerohet e as të demontohet.

Puseta e tretë është te kryqëzimi i rrugës M.Lakuci. Kjo do të shërbej për kryerjen e nyjes degëzuese nga Ø300/Ø150, me nga një valvulë.

Puseta e katërt është te kryqëzimi me rrugën Xh.Hana, e cila gjendet krejtësisht në rrugë. Këtu ekziston nyja degëzuese për rrugën Skenderbeu, Washingtoni dhe Xheladin Hana. Edhe në këtë nyje janë paraparë valvula për secilën degëzim (Ø250 dy copë, Ø150 një dhe Ø100 një, prandaj është paraparë zgjerimi i pusetës.

Puseta e pestë është e fundit, te kryqëzimi me rrugën Yll Morina, afër mishtores Cana. Kjo nyje ka degëzimin Ø150 dhe vazhdimin me Ø150 (e cila nuk është pjesë e këtij projekti). Edhe kjo pusetë duhet të zgjerohet, për shkakun se në planin zhvillimor është i paraparë kyqja nga vazhdimi i Ø400.

Në këtë potez kemi edhe nyje degëzuese të cilat nuk kanë puseta. Degëzimi me rrugën Marin Barleti, me rrugën Mbretresha Teuata, me rrugën Ferhat Binishi, me rrugën Abedin Terbeshi, me rrugët Musa Zajmi – Armando Pailad. Për këtë ne kemi parashikuar ndërtimin e pusetave të reja me dim. të brendshme 1,60x1,40m. Nëse kemi parasyshë se te kryqëzimi me rrugën A.Terbeshi nuk ekziston mundësia e ndërtimit të pusetës, atëherë ne kemi paraparë ndërtimin e 4 pusetave të reja.

Në këtë trasë, krahas gypave të ujësjellsit, ekzistojnë infrastruktura tjera nëntokësore. Kabllot e PTK-së janë pothuaj ngjiturazi me gypat tanë të ujësjellsit, por me thellësi më të vogël. Ne mendojmë se në pjesë të caktuara ekzistojnë edhe kabllot elektrike, një prerje me tubat e nxemjes qendrore dhe në katër raste me ato të IPKO-së. Prandaj ne do të kërkojmë nga këto ndërmarrje publike të dhëna më të sakta me sa më shumë shënime.

Sigurisht që edhe pengesat tjera do të jenë pjesë e këtij projekti, pra edhe ato që shifen. Në këtë trasë PTK-ja ka së paku 3 puseta të cilat janë mbi trasën e këtij projekti. Prandaj për këtë shkak kemi parashikuar nënkalime të mbrojtura me gypa më të mëdhenjë.

Për demolim dhe rivendosje janë edhe 4-5 ujëmbledhësa rrugor, komplet me gypin vertikal.

Pastaj do të kemi shenja të trafikut të cilat do të hiqen dhe më pas do të rivendosen.

E njohur për ne është edhe kabina nga pleksiglasit, për stacionemet e autobusve lokal, dhe që e njëjta duhet të hiqet dhe të rivendose pas përfundimit të punëve.

Më të vërejtshme janë edhe dëmtimet e drunjëve, rrënjët e të cilave do të priten dhe dëmtohen, prandaj kjo do të jetë e pamatshme dhe nuk i kemi paraparë në këtë projekt. Gjatë ekzekutimit të punimeve ato mund të vlerësohen, dhe të njëjtat duhet të zëvendësohen me mbjelljen e të rejave. Gjatë ekzekutimit të punimeve mund të ndodhë që të dalin punime të paparapara. Këto punime do të llogariten si punë shtesë.

1. Vërejtje paraprake për numrin e ekipeve punuese dhe mjeteve me makineri; Ofertuesi duhet të na siguroj me deklaratë, për punime të përnjëhershme, në vende të ndryshme, me të paktën:

- 2 ekipe punuese për punimet tokësore (ekipe me numër të madhë punëtorësh fizik);
- 2 ekipe punuese për punimet instaluese dhe për montimin e gypit
- 2 ekipe për kyçje shtëpiake
- 2 ekipe për punët ndërtimore
- 2 aparate salduese
- Mjetet dhe makinerit (bager, minibager, kamion me kiper, damper e tj.)

2. Vërejtje paraprake për demontimin (dhe largimin) e materialeve; Demontimi / largimi i materialeve nënkupton të gjitha shpenzimet për demontim dhe shpenzimet e transportimit deri në deponinë të cilën e cakton KK e Gjakovës.

3. Materialet për punët instaluese dhe montimin e gypave; Për instalimin e fittingjeve dhe gypave sipas paramasës dhe parallogarisë, ofertuesi duhet t'i përfshijë të gjitha punët dhe materialet e nevojshme për realizimin në tërësi nga përshkrimi i punëve. Furnizimi me materiale dhe montimi i tyre, gjithashtu duhet të përfshihen në koston njësi të përshkrimit.

4. Vërejtjet paraprake për materialet specifike; Në parim ofertuesi mund të ofroj një lloj tjetër të materialit vetëm nëse ai produkt është ekuivalent sipas specifikave teknike dhe standardeve të kërkuara. Në këtë rast duhet të na dorëzoj të gjitha informacionet e nevojshme për të provuar vlerat e barabarta me ato të llogaritura, përndryshe Ofertuesi do të përjashtohet.

5. Vërejtjet paraprake për infrastrukturat tjera komunale nëntokësore; Investitori do të siguroj pëlqimet me shënimet e përgjithshme nga ndërmarrjet tjera komunale dhe lejen e punimeve nga urbanizmi i KK të Gjakovës, ndërsa përfituesi i tenderit do të siguroj shënimet dhe të dhënat detale mbi infrastrukturat e KEK-ut, PTK-së, Ngrohtores së qytetit dhe IPKO-s, dhe në rastet e dëmtimeve, shpenzimet për sanim i bartë ofertuesi përfitues i tenderit, në bashkëpunim me ndërmarrjen përkatëse. Këshilla jonë është që kompetentët e këtyre ndërmarrjeve publike, ti ftoni në vendin e ngjarjes për ti kqartësuar të dhënat e tyre (qoft nevoja edhe me shkrim). Gjithashtu, e njëjta vlenë edhe për ndonjë dëmtim fizik i ndonjë prone gjatë punimeve.

6. Vërejtjet paraprake për ndërprerjet e furnizimit me ujë; Ndërprerja e furnizimit me ujë të konsumatorëve, nuk mund të zgjatë më shumë se 8 orë në ditë, përveç në rastet e paparashikuara, dhe ate duke e paralajmëruar përmes mediave (radio Gjakova, TV Syri) dhe përmes afisheve/pllakateve në vende të dukshme në fillim dhe në fund të zonës së ndërprerjes.

7. Vërejtje paraprake për paushallin; Paushalli nënkupton koston e përgjithshme, përfshirë përdorimin e të gjithë materialit të nevojshëm, mjeteve dhe makinerive si dhe tërë fuqinë punëtore e cila do të angazhohet deri në kryerjen e plotë të punimeve nga përshkrimi.

8. Vërejtje paraprake për sigurinë gjatë punimeve në vend punishte; Sigurimi i vend punishte është përgjegjësi e ofertuesit, përfitues i tenderit. Gjithashtu hapësirat me më shumë punë-kryes janë pjesë e marrëveshjes në mes të përfituesit të tenderit dhe punë kryesve të vend-punishteve tjera. Komunikacioni gjatë punimeve duhet të jetë i rregulluar në pajtim me kërkesat e zyrtarëve të komunikacionit në KK të Gjakovës. Për segmentet ku duhet prerë asfalti në rrugë (si pozicione më të ndjeshme) ato paraprakisht paralajmërohen duke respektuar edhe afatin kohor të kthimit të gjendjes funksionale. Vështirësimi i ushtrimit të aktivitetit të ndonjë prone (shitore/lokale afariste) nuk guxon të zgjatet më shumë se 48 orë (përveç nëse për këtë shfaqen të papritura të arsyetueshme). Për të njëjtit sigurohet kalimi i atyre banorëve në dyja anët, me gjerësi shkelëse 90cm dhe parrmak në dyja anët në lartësi po ashtu 90cm.

9. Vërejtje paraprake për instalimet në zonën e punimeve; Instalimi në zonën e punimeve nënkupton të gjitha punët përgatitore:

- Marrja e të dhënave për infrastrukturën nëntokësore nga ndërmarrjet tjera publike, në formën e shkruar dhe shpjegimet në trasë (në teren),
- Shënjimi i trasesë,
- Hapja e shlicave për verifikimin e infrastrukturave (gropimi me dorë i detyrueshëm)
- Verifikimi i gjendjes së pusetave
- Incizimi i asfaltit rrugor, në trotuare, i kubëzave, pllakëzave dhe betoneve
- Përgatitjet e pllakatave paralajmëruese
- Përgatitja dhe ushtrimi me rregullat e komunikacionit sipas rregullave dhe instruksioneve nga Policia e trafikut, e tj.

10. Vërejtje paraprake për punët demontuese;

- Të gjitha punimet e nevojshme për demontimin e pusetave nënkupton (betonin dhe armaturën), punë të dheut, materialin mbushës dhe të gjithat sipas skicave;
- Të gjitha gypat që demontohen priten në kënd të drejtë, duke përdorur pajisje adekuata, për ri kyçjen e sërishme me gypat e ri, sikur që është përcaktuar nga prodhuesi. Për prerjen e azbestit nevojiten maska dhe dorezat mbrojtëse nga pluhuri i AC-së.

11. Vërejtje paraprake për punimet tokësore – gropimet; Gropimi i trasesë bëhet në përputhje me normativat DIN 4124, pra e njëjta sigurohet, varësisht prej strukturës së dheut dhe ngarkesave mbi te. Dheu i tepërt nga gërmimi dhe që është i përshtatshëm për ripërdorim deponohet në deponi të përkohshme, përderisa dheu i cili nuk bënë të ripërdoret largohet për në deponin e caktuar nga organet kompetente të KK të Gjakovës. Shtresat nën dhe mbi gyp janë nga rëra në përputhje me normativat DIN EN 1610, dhe lartësia varësisht nga profili i gypit. Kjo shtresë duhet ngjeshur deri në arritjen e kompaktësisë deri PDr-95%. Ri kthimi i dheut-zhavorrit i përshtatshëm për rimbushje dhe materiali shtesë për mbushje, bëhet në shtresa 30cm, me përmbajtje të nevojshme të lagështisë dhe kompaktësohet me ngjeshje sipas normativave DIN 18300 deri PDr-98%. Gjerësia e kanalit e caktuar në përshkrim pranohet të jetë më e ngushtë për maksimum 10 cm, për rastet e domosdoshme, ndërsa zgjerimi i gropimit nga specifikimet teknike nuk llogariten si punë shtesë.

Gropimi me dorë fillimisht ka të bëjë me hapjen e shlicave për vërtetimin e trasesë së ujësjellësit ekzistues me ç'gjë përcaktohet vija e prerjes së asfaltit, betoneve, heqjes së kubëzave dhe zbulimi i infrastrukturave tjera nëntokësore. Gjithashtu, gropimi me dorë bëhet për gjatësinë e trasesë ku infrastrukturat nëntokësore të ndërmarrjeve tjera (sipas shënimeve të dhëna nga ta) dhe nga ato të zbuluara e që janë mbi, pranë ose kryqëzohen me trasenë tonë punuese, ku gropimi me dorë bëhet për gjerësinë e njëjtë sipas paramasave dhe në thellësi të nevojshme derisa të vërtetohet se a mundë të vazhdohet me gropim me makineri.

Gropimi me makina bëhet në trasenë e njohur (sipas të dhënave të ofruara) pa infrastrukturë nëntokësore të ndërmarrjeve tjera. Gjerësia e gropimit është e njëjtë dhe thellësi deri në fundin e shtratit të gypit ekzistues.

Gjerësia e gropimit është 80cm, thellësia deri 2m.

12. Vërejtje paraprake për kalimet-depërtimet në trasenë punuese; Shënimet e mëposhtme janë pjesë përbërëse e kontratës dhe paguhet në bazë të përlllogaritjeve gjatë punimeve të kanalit dhe montimit të gypit. Gypi i ujësjellësit i cili punohet me këtë projekt, gjatë kryqëzimeve me infrastrukturat tjera duhet të mbrohet dhe të plotësoj kushtet e kryqëzimeve, kalimeve nënkrahas-mbi sipas normativave për këto punë. Kalimet tërthore të kanalizimit gjithashtu duhet ti plotësojnë kushtet dhe normativat e punimit. Duhet parashikuar që në këto vende i tërë gropimi duhet të mbushet me rërë duke i ndërmarrë masat siguroese dhe mbrojtëse. Puna do të paguhet në bazë të skicimit të këtyre rasteve, të pranuar dhe nënshkruar nga ana e mbikëqyrësit. Pozicionet e papranuara dhe të mbuluara nuk do të merren parasysh. Nënkalimi me mbrojtje që është deri në 30 cm do të jetë pozicion i pagueshëm sipas materialit shtesë, ndërsa mbi 30 cm merret si pozicion shtesë për pagesë përveç materialit edhe puna shtesë. Kjo do të quhet në paramasë si nënkallim.

13. Vërejtje paraprake për punimet e asfaltit dhe kubzave të betonit; Pas shënjëzimit të vijave nëpër trasenë e rrugës, me gjerësi 1.2m, bëhet prerja e të dy shtresave të asfaltit. Gjithashtu, e njëjta bëhet edhe për në trotuare. Në trotuare kemi edhe kubëza- pllakëza betoni, ose/dhe pllato të betonuara. Rastet me kubëza- pllakëza betoni, demontohen në të njëjten gjerësi dhe deponohen përkohësisht për tu shtruar përsëri. Rastet e pllatove nga betoni bëhen sikur për asfaltin e trotuarit shënohet në të njëjtën gjerësi, prehet, ngarkohet dhe transportohet.

Shtuarja e asfaltit në rrugë bëhet me shtresat e trashësisë së njëjtë, kubëzat-pllakëzat e betonit qëparë të deponuara përkohësisht rivendosen, si dhe pllatoi e betonit rishtohen me të njëjtën trashësi. Thënë shkurt bëhet kthimi i gjendjes së mëparshme.

Shtresa bazë e nën asfaltit është nga guri i grimcuar, me madhësi 0/32mm si shtresë e parë prej 20cm, ndërsa si shtresë e dytë dhe finale gjithashtu nga guri i grimcuar, me madhësi 0/12mm me një trashësi 20cm. Të dyja këto ngjeshën deri në kompaktësinë prej PDr-98%.

Përbërja e asfaltit:

- Materiali mbushës nga granulati i imët, 3-10% e masës,
- Materiali mbushës nga granulati i trashë, 60-80% e masës,
- Përmbajtja bituminoze minimum 4%, (B 65),
- Stabilizues 5.0 kN në 60°C,
- Koeficienti i zbrazësisë 4-10% të masës.
- Materiali mbushës për shtresën e parë 0-16mm,
- Materiali mbushës për shtresën e dytë 0-8mm.

Në fund, e gjithë puna e kthimit të gjendjes së mëparshme, duhet të pranohet nga organi mbikëqyrës. Në përbërje të këtij organi mbikëqyrës, përveç nga KRU "Radoniqi" do të jetë prezent edhe përfaqësuesi nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Rural.

14. Vërejtje paraprake për punët instaluese – gypat dhe fittingjet; I gjithë materiali i cili është paraparë për instalim në puseta (gypat FF, T pjesët, kthesat 45°/90°, redukuesit e tj) janë nga gusi, dhe në mes vete lidhen përmes bulonave. Ndërsa pjesët lidhëse (T pjesët, kthesat 45°/90°, redukuesit, adapter flanaxhat e tj.) të cilat janë paraparë të jenë në trasë dhe të mbuluara janë nga materiali PE100 të cilat vazhdojnë me saldim.

Gypat dhe fittingjet nga PEHD

Pozicioni i gypave nga PEHD nënkupton: sigurimin, transportin, shtrirjen, montimin dhe lidhjen e tyre. Porosia kryesore është që e tërë puna për lidhjen e gypave HDPE duhet të kryhet me pajisje salduese elektrofuzive. Kjo duhet të parashihet në paralogaritje të paramasës, nëse në paramasë nuk parashihet ndryshe. Gypat shtrihen në shtresën e rërës 10cm, me planifikim ±3cm, të ngjeshur deri në kompaktësimin e nevojshëm. Gjithashtu ato mbulojnë me shtresën mbi dhe anash gypit me trashësi 20cm, të ngjeshur deri në kompaktësimin e nevojshëm (shih në vërejtjet paraprake të punimeve tokësore).

Gypat do të jenë nga materiali PE100, polietileni me dendësi të lartë (HDPE) dhe me shtresën izoluese (PEAD), për ngarkesa të presionit të caktuar prej PN10 bara, me raport të rrezes së jashtme/trashësi të mureve SDR17, gjithnjë sipas normativave DIN EN 1555, EN 12201, DIN 8074/75. Bashkimi i gypave do të bëhet me pajisje elektrofuzive. Gypat me ngjyrë të zezë me vija të kaltra, të prodhuara me ekstrudim të përnjëhershëm, të destinuara për presionin e kërkuar duhet të jenë në përputhje me kërkesat higjienike-sanitare dhe për përdorimin e furnizimit me ujë të pijshëm. Për gjithë këto, paraprakisht, ofertuesi, në dokumentacionin e ofertimit duhet të bashkëngjijë atëstin nga prodhuesi, sipas normativave të lartshënuara (si e detyrueshme!).

Valvulat

Pozicioni i valvulave nënkupton: sigurimin, transportin, montimin dhe lidhjen e tyre me të gjitha pjesët përbërëse dhe ndihmëse (dihtung gomat, bulonat e tj.) Porosia kryesore është që valvulat janë të presionit PN 16, me flanaxhë në dyja anët, sipas normativave DIN 3352/P4, me dimensionet skaj më skaj sipas EN558-1 GR14 të versionit të shkurtër (DIN3202-F4). Trupi dhe pjesa e epërme metali daktil EN-GJS-400-18 në përputhje me EN 1563 (GGG400-DIN1693) me lyerje për mbrojtje kundër korrozionit nga brenda dhe nga jashtë sipas DIN30677-P2. Trashësie e lyerjes (DFT) prej 250µm e puqur për metalin daktil. Në vetë trupin e valvulës duhet të jenë shenjat e gravura nga prodhuesi si dokumentim i prodhimit dhe kontrollimit të tyre, duke i bashkëngjitur edhe atëstet e shkruara.

Valvulat me teleskop garniturë

Pozicioni i valvulave me teleskop garniturë nënkupton: sigurimin, transportin, montimin dhe lidhjen e tyre me të gjitha pjesët përbërëse dhe ndihmëse (dihtung gomat, bulonat, teleskopin e përmasës gjegjëse e tj.). Pos asaj që u tha për valvulat (e njëjta vlen), në këtë rast materiali i teleskopit duhet të jetë i futur në gypin mbrojtës sipas DIN-GG25, Rst.37 K gal Zn/Plastik.

Hidrantët nëntokësor

Pozicioni i hidrantëve nëntokësor nënkupton: sigurimin, transportin, montimin dhe lidhjen e tyre me të gjitha pjesët përbërëse dhe ndihmëse (dihtung gomat, bulonat, e tj.). Hidrantët nëntokësor duhet të jenë në përputhje me normativat DIN2501, PN16 dhe GGG40. me unaz të mesingut, me membranë etilen propilen, vrimat sipas UNI 2237 dhe DIN 2533.

Kapakët rrugor për hidrantë

Pozicioni i kapakëve rrugor për hidrantë nëntokësor nënkupton: sigurimin, transportin, montimin dhe përforcimin në pozicion të rrafshët me shtresat e asfaltit, kubëzave ose betoneve, gjithnjë në përputhshmëri të normave DIN 4057, GG25. E njëjta vlenë edhe për kapakët e valvulave me teleskop.

Adapter flanaxhat

Pozicioni i adapter flangjeve nënkupton: sigurimin, transportin, montimin dhe/ose saldimin e tyre, varësisht nga paramasa me parallogarit. Adapter flanaxhat nga giza duhet ti plotësojnë kërkesat e normativave, ngjashëm me ato produkte të cekura më parë, GGG40 në përputhje me ISO 7005-2, ISO2531, EN 1092-2, PFA16bara.

Ndërsa AF mitingjet nga PE100 me flanaxhën sipas DIN 2501, dhe vazhdohen me saldim elektrofuziv.

Qaforet për rikyqje

Qaforet për rikyqje nënkupton: sigurimin, transportin, montimin dhe të gjitha pjesët tjera për rikyqjen e gypave furnizues të konsumatorëve. Në çmim duhet të parashikohen edhe nga një brryl, hollender, gjysëmlidhëse dhe deri 1m gyp. Ky pozicion edhe për ne është i panjohur, prandaj paramana është e supozuar. Sidoqoft, vendimi për lejim të pagesës bëhet nga ana e mbikëqyrësit duke i verifikuar në vendngjarje.

15. Vërejtjet paraprake për punët tjera

- **Shqyrtimi i provës nën presion** bëhet për krejt gypat dhe fittingjet e instaluara. Kjo provë bëhet duke rritur presionin për 1.5 herë më shumë se presioni punues, për 3 orë pa ndërprerje, krejtësisht sipas DIN 4279
- **Dezinfektimi i gypave dhe fittingjeve** bëhet pas shqyrtimit të provës nën presion. Për dezinfektim përdoret Hipokloriti i kalciumit – CaOCl me përmbajtje 2% dhe lihet në gypa për 20 orët e ardhshme pa ndërprerë. Pas kësaj gypi shpëlahet me ujin nga rrjeti i ujësjellësit. Pas gjithë kësaj merren mostrat nga ky gyp dhe dërgohen për analiza ku provohet se a i përmbushë kërkesat për lejimin e tijë për pije.
- **Testimi i ngjeshmërisë** bëhet sipas DIN 4094.

Nr.r.	Përshkrimi i pozicionit	Sasia	Nj.m.	Çmimi me TVSH	Shuma
1 INSTALIMET NE ZONËN E PUNIMEVE					
1.1	Punët përgatitore, shënimi dhe verifikimi i trasesë ndërtimore, nga të gjitha punët e përmendura në kushtet e përgjithshme dhe teknike	paushall	1.0		
Gjithsejt instalimet në zonën e punimeve:					
2 PUNËT E DEMONTIMIT					
2.1	Demontimi i gypit AC Ø150mm dhe fittingjeve	m	203.89		
2.2	Demontimi i gypit AC Ø250mm dhe fittingjeve	m	977.16		
2.3	Demontimi i gypit AC Ø300mm dhe fittingjeve	m	108.56		
2.4	Demontimi i pusetave nga BA në njërën anë	copë	3		
2.5	Demontimi dhe rimontimi i 5 ujëmbledhsave rrugor	copë	5		
2.6	Demontimi dhe rimontimi i gurëve anësor rrugor	m	90		
Gjithsejt punët e demolimit:					
3 PUNËT TOKËSORE					
3.1	Gërmimi në kat. III-IV sipas vërejtjeve paraprake				
	Gropim me dorë	m ³	1034		
	Gropim me makina	m ³	1034		
3.2	Gërmimi në dherat e kat. III-IV për ndërtimin e 4 pusetave me dim. 1.8x1.4x2.0m (gërmim i zheruar)	m ³	69.12		
3.3	Rëra 0-1mm, trashësi 10cm për shtratin nën gyp me planifikim ±3cm, sipas vërejtjeve paraprake për punimet tokësore.	m ³	103.17		
3.4	Rëra 0-1mm, trashësi 20cm mbi gyp, sipas vërejtjeve paraprake për punimet tokësore.	m ³	944.81		
3.5	Mbushja e kanalit me dheun e gropuar e të përzgjedhur, sipas vërejtjeve paraprake për punimet tokësore	m ³	1676.49		
3.6	Shtresa e fundit para shtresës së asfaltit sipas vërejtjeve paraprake për punimet tokësore	m ³	128.96		
Gjithsejt punët tokësore:					
4 PUNËT E ASFALTIMIT DHE KUBEZAVE					
4.1	Prerja dhe demolimi i asfaltit në rrugë (415.59x1.2)	m ²	414.4		
4.2	Prerja dhe demolimi i asfaltit në trotuare (316x1.2)	m ²	379.2		
4.3	Demolimi i kubëzave, me dim. të ndryshme, në trotuare dhe rrugë dhe deponimi i përkohshëm	m ²	428.4		
4.4	Prerja e betonit në trotuare (202x1.2)	m ²	242.4		
4.5	Shtruarja e shtresës së asfaltit në rrugë	m ²	414.4		
4.6	Shtruarja e shtresës së asfaltit në trotuare	m ²	379.2		
4.7	Shtruarja e kubëzave të deponuara më parë	m ²	428.4		
4.8	Shtruarja e betonit në trotuar	m ²	242.4		
Gjithsejt punët e asfaltit dhe të kubëzave:					


5 NDËRTIMI I PUSETAVE					
5.1	Shtruarja e betonit të thjesht MB10 si shtresë rrafshuese dhe hidrozolimi me dy shtresa bitumini	m ³	1.5		
5.2	Shtruarja e kondorit 4mm, sipas kushteve të cekura	m ²	16		
5.2	Betonimi i mureve të pusetës me beton të markës MB30	m ³	2.72		
5.3	Betonimi i soletës së pusetave me beton të markës MB30	m ³	2		
5.4	Punimi i armaturës në përputje me DIN 488	kg	1260		
5.5	Montimi i kapakëve për puseta me hapje të pastër Ø700m	copë	4		
5.6	Montimi i shkallëve për pusetat	copë	24		
5.7	Hidroizolimi me dy shtresa nga ana e jashtme e mureve të pusetave dhe kondor 4mm me mbrojtje	m ²	58		
5.8	Betonimi i pusetave për zgjerim	m ³	1.96		
Gjithsejt ndërtimi i pusetave:					
6 PUNET INSTALUESE - GYPAT DHE FITINGJET					
Gypat PEHD 10bara SDR 17					
6.1	Ø315mm	m	930		
6.2	Ø250mm	m	360		
Valvulat për puseta					
6.3	DN 300, PN16	copë	5		
6.4	DN 250, PN16	copë	3		
6.5	DN 150, PN16	copë	3		
6.6	DN 100, PN16	copë	2		
6.7	DN 80, PN16	copë	10		
Valvulat flutur					
6.8	DN 500	copë	1		
6.9	DN 350	copë	1		
6.10	DN 300	copë	1		
Valvulat me teleskop					
6.11	DN 50 (H=1 - 1.5, për DN 50-65)	copë	20		
6.12	DN 65 (H=1 - 1.5, për DN 65-80)	copë	5		
6.13	DN 80 (H=1 - 1.5, për DN 80-100)	copë	4		
6.14	DN 100 (H=1 - 1.5, për DN 100-125)	copë	2		
6.15	DN 150 (H=1 - 1.5, për DN 125-150)	copë	2		
6.16	DN 200 (H=1 - 1.5, për DN 200-250)	copë	1		
6.17	DN 250 (H=1 - 1.5, për DN 250-300)	copë	3		
6.18	DN 300 (H=1 - 1.5, për DN 250-300)	copë	4		
Hidrant nëntpkësorë					
6.19	DN 80/1100	copë	7		
Kapak rrugor të hidrantëve nëntokësorë					
6.20	Ø270/190/270	copë	7		

	Kapak rrugor për valvulat me teleskop				
6.21	Ø210	copë	15		
6.22	Ø125	copë	25		
	Valvulë ajri				
6.23	DN80, PN16	copë	1		
	Adapter flaxhë për AC				
6.24	AC DN 500,	copë	1		
6.25	AC DN 350	copë	2		
6.26	AC DN 250	copë	3		
6.27	AC DN 150	copë	1		
6.28	AC DN 125	copë	1		
6.29	AC DN 100	copë	2		
6.30	AC DN 80	copë	2		
	AF për PEHD, PE100, PN16, SDR17				
6.31	DN 315	copë	16		
6.32	DN 250	copë	7		
6.33	DN 90	copë	20		
	FF, kthesa, T dhe përfundime nga giza				
6.34	Pjesët fazonike, komplet sipas vërejtjeve paraprake	kg	5347		
	Pjesët montuese demontuese				
6.35	DN 250	copë	2		
6.36	DN 315	copë	4		
6.37	DN 500	copë	1		
	"T" reduktuese PEHD, PE100, PN16, SDR17				
6.38	DN 315/90	copë	7		
6.39	DN 250/90	copë	3		
	Qafore për kyqje (ambroshe)				
6.40	Ø300/1"-2"	copë	50		
6.41	Ø250/1"-2"	copë	40		
Gjithsejt punët instaluese:					
	7 PUNET TJERA				
7.1	Shqyrtimi i rrjetit sipas vërejtjeve paraprake	m	1290		
7.2	Dezinfektimi i gypave sipas vërej. paraprake	m	1290		
7.3	Shqyrtimi i ngjeshmërisë sipas vërej. paraprake	copë	12		
Gjithsejt punët tjera:					

REKAPITULIM

1.Punët e instalimit në zonën e punimeve	
2.Punët e demontimit	
3.Punët e dheut	
4.Punët e asfaltit dhe kubëzave	
5.Punët e ndërtimit të pusetave	
6.Punët instaluese - gypat dhe fittingjet	
7.Punët tjera	
Totali:	











Në trotuar nga Xhamia e re deri te ndërtesa e Ahmave



Trotuar te parkingu i Emrave dhe kalimi i rrugës M.Lakuci

















PUSETA ME DIMENSIONET 160/140




Detali i armaturës së pllakës së epërme


Ø	gjatësia	kilogram
10	92.00	69.00
10	37.20	27.90
10	4.12	3.09
10	2.40	1.80
10	4.04	3.03
10	10.92	8.19
10	4.9	3.68
10	9.25	6.94
10	3.38	2.53
10	3.52	2.64
10	4.80	3.60
	Gjithsejt:	kg 132.39







Armatura e mureve dhe e bazamentit







Detali i hidrantit nëntokësorë






Detali i valvulës së ajrit

Nr. i komponentës	Vlera	SHEMA E NYJEVE	Tabela e komponentëve (Vlera dhe sasia)	Kostoja e komponentëve (Euro)	Kostoja e punës (Euro)
1-3	12V		1. 40F @ 35V 2. 100p @ 50V 3. 100p @ 50V 4. 100p @ 50V 5. 100p @ 50V 6. 100p @ 50V	120	
1-3	12V		1. 40F @ 35V 2. 100p @ 50V 3. 100p @ 50V 4. 100p @ 50V 5. 100p @ 50V 6. 100p @ 50V	100	
1-4	12V		1. 40F @ 35V 2. 100p @ 50V 3. 100p @ 50V 4. 100p @ 50V 5. 100p @ 50V 6. 100p @ 50V 7. 100p @ 50V 8. 100p @ 50V	120	
1-4	12V		1. 40F @ 35V 2. 100p @ 50V 3. 100p @ 50V 4. 100p @ 50V 5. 100p @ 50V 6. 100p @ 50V 7. 100p @ 50V 8. 100p @ 50V	120	

NUMRI I SHKURTYRË	SHENJA E NYJEVE	SHENJA E NYJEVE (PËRSHKËRTO)	NUMRI I NYJEVE	SHENJA E NYJEVE	NUMRI I NYJEVE
5		<p>1. $R = 300 \Omega$</p> <p>2. $R = 315 \Omega$</p> <p>3. $R = 300 \Omega$</p> <p>4. $R = 315 \Omega$</p> <p>5. $R = 300 \Omega$</p> <p>6. $R = 315 \Omega$</p>	<p>1</p> <p>2</p> <p>2</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p>	<p>100</p> <p>100</p> <p>100</p> <p>100</p> <p>100</p> <p>100</p>	
6		<p>1. $R = 300 \Omega$</p> <p>2. $R = 315 \Omega$</p> <p>3. $R = 300 \Omega$</p> <p>4. $R = 315 \Omega$</p> <p>5. $R = 300 \Omega$</p> <p>6. $R = 315 \Omega$</p> <p>7. $R = 300 \Omega$</p>	<p>1</p> <p>2</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>2</p> <p>1</p>	<p>100</p> <p>100</p> <p>100</p> <p>100</p> <p>100</p> <p>100</p> <p>100</p>	
7		<p>1. $R = 300 \Omega$</p> <p>2. $R = 315 \Omega$</p> <p>3. $R = 300 \Omega$</p> <p>4. $R = 315 \Omega$</p> <p>5. $R = 300 \Omega$</p> <p>6. $R = 315 \Omega$</p> <p>7. $R = 300 \Omega$</p>	<p>1</p> <p>2</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>2</p> <p>1</p> <p>1</p>	<p>100</p> <p>100</p> <p>100</p> <p>100</p> <p>100</p> <p>100</p> <p>100</p>	
8		<p>1. $R = 300 \Omega$</p> <p>2. $R = 315 \Omega$</p> <p>3. $R = 300 \Omega$</p> <p>4. $R = 315 \Omega$</p> <p>5. $R = 300 \Omega$</p> <p>6. $R = 315 \Omega$</p> <p>7. $R = 300 \Omega$</p> <p>8. $R = 315 \Omega$</p> <p>9. $R = 300 \Omega$</p>	<p>1</p> <p>2</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>2</p> <p>1</p> <p>2</p> <p>1</p> <p>1</p>	<p>100</p> <p>100</p> <p>100</p> <p>100</p> <p>100</p> <p>100</p> <p>100</p> <p>100</p> <p>100</p>	

Nr.	Mbrojtja e shtetit	SHEMA E NYJEVE	PËRSHIRJE E SHUMËTË (PËRSHIRJE E SHUMËTË)	Koha e punës (në orë)	Vlerësimi i punës	
10	M7		1. T. 200/100 2. D. 200/100 3. D. 200/100 4. R. 100/100 5. R. 100/100 6. D. 200/100 7. D. 200/100 8. D. 200/100 9. D. 200/100 10. R. 100/100	1 1 1 1 1 1 1 1 1 1	122 180 112 18/50 16/10	
11	M8		1. T. 200/100 2. D. 200/100 3. D. 200/100 4. R. 100/100 5. R. 100/100 6. D. 200/100 7. D. 200/100 8. D. 200/100 9. D. 200/100 10. R. 100/100	1 1 1 1 1 1 1 1 1 1	129 95 48 100/50	
12	M9		1. T. 200/100 2. D. 200/100 3. D. 200/100 4. R. 100/100 5. R. 100/100 6. D. 200/100 7. D. 200/100	1 1 1 1 1 1 1	88 156 100/50	
13	M10		1. T. 200/100 2. D. 200/100 3. D. 200/100 4. R. 100/100 5. R. 100/100	1 1 1 1 1	44 114	

KODI	TYPË E NYJEVE	SHEMA E NYJEVE	MATERIALI (KODI I MATERIALIT)	KANT. (KANT.)	VLERË TËRTORE	VLERË TËRTORE
10	M/O		<ul style="list-style-type: none"> 1 P d 250/250 2 O d 250 AM/O 3 P d 250/250 4 O d 250 5 O d 150 AM/O 6 P d 150/250 7 O d 150 	<ul style="list-style-type: none"> 1 1 2 2 1 1 1 	<ul style="list-style-type: none"> 100 150 40000 	
11	M/O		<ul style="list-style-type: none"> 1 P d 250/250 2 O d 250 AM/O 3 P d 250/250 4 O d 250 5 O d 150 AM/O 6 P d 150/250 7 O d 150 	<ul style="list-style-type: none"> 1 1 2 1 		
15	M/O		<ul style="list-style-type: none"> 1 P d 250/250 2 O d 250 AM/O 3 P d 250/250 4 O d 250 5 O d 150 AM/O 6 P d 150/250 7 O d 150 	<ul style="list-style-type: none"> 1 2 3 1 1 2 	<ul style="list-style-type: none"> 100 200 200 	